



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

4195
Nr. Prot.

Tiranë, më ___/08/2013

URDHËR

Nr. *343*, datë *19.08.2013*

PËR

**MIRATIMIN E DISPOZITAVE NORMATIVE PËR SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 73 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe njësitë arsimore vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MYQEREM TAFAJ

MINISTËR

